



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 17926 Prot

Lezhë, më 02/11/2022

VENDIM

Nr. 116, Datë 31. 10.2022

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES STANDARDE MIDIS SAVE THE CHILDREN DHE  
BASHKISË LEZHË PËR PROJEKTIN "KËND LOJRASH" NË SHKOLLËN 9-  
VJEÇARE "MARASH GJONI", RRILË, LEZHË

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Thirrjen për propozime referencë 2022/02 për grante të vogla për bashkitë për ndërtimin e këndeve të lojrave dhe kopshteve (Bahçeve) në disa shkolla të përzgjedhura në kuadër të projektit "Shkollat për Shëndetin" nga organizata Save the Children, shkresës Nr. 14711 Prot., Datë 31.08.2022 dërgim aplikimi për projektin "Shkollat për Shëndetin" nga Bashkia Lezhë, marrëveshjes standard lidhur ndërmjet Save the Children dhe Bashkisë Lezhë datë 07.10.2022 për projektin "Kënd Lojrash " në shkollën 9-vjeçare "Marash Gjoni" Rrilë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes standarde të nëngrantit për projektin "Kënd Lojrash " në shkollën 9-vjeçare "Marsh Gjoni" Rrilë, Lezhë.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Prot 17926/  
17.11.22.

Nr. 799/3 Prot.

Lezhë, më 07.11.2022

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË


Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2, germa "b" të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.116, datë 31.10.2022 të këshillit të bashkisë Lezhë, për "Miratimin e marrëveshjes standarte midis Save the Children dhe Bashkisë Lezhë për projektin "Kënd Lojrash" në shkollën 9-vjeçare "Marash Gjoni", Rrilë, Lezhë.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI





**MARRËVESHJE STANDARDE NËNGRANTI**

midis

Save the Children, Programi për Shqipërinë

(më poshtë quajtur "SC")

Tiranë, Shqipëri

dhe

Bashkia Lezhë

(më poshtë quajtur "Partneri")

Lezhë, Shqipëri

Për projektin:

**Kënd Lojrash në shkollën 9 vjeçare "Marash Gjoni", Rrilë, Lezhë**

Numri i marrëveshjes së Nëngrantit:

Kjo Marrëveshje bëhet ndërmjet SC dhe Partnerit për të ndërmarrë aktivitete specifike në kuadrin e projektit të mëposhtëm ("Projekti"):

- Anëtari i Save the Children: { SAVE THE CHILDREN SHQIPERI }
- Donatori: Swiss Agency for Development and Cooperation
- Numri i Marrëveshjes me Donatorin: SOF 75600468
- Donatori fillestar: NA
- Numri i Grantit të Donatorit Original: NA
- Vendi (shteti) i zbatimit: Lezhë, Shqipëri
- Emri/Përshkrimi i projektit:

#### **Kënd Lojrash në shkollën 9 vjeçare "Marash Gjoni", Rrilë, Lezhë**

- Shuma Totale e Parashikuar për Projektin:

1,123,668.000 ALL (një milionë e njëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë lekë)

- Shuma Totale e Parashikuar për Partnerin:

898,934.000 ALL (tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër lekë) për Kënd Lojrash në shkollën 9 vjeçare "Marash Gjoni", Rrilë, Lezhë;

- Financimi i Barasvlershëm:
- SoF i SC: 75600468
- Kodi i Partnerit: XXXX
- Kodi i Marrëveshjes me Partnerin: {NUMRI}
- Kodi Identifikues i Organizatës në kuadrin e IATI (nëse është e rastit): NA
- Tipologjia e organizatës në kuadrin e IATI:
  - **Pushteti lokal;**
- A i jepet IATI-t leja për botim?: {PO}

Detajet e Projektit janë përcaktuar në Përshkrimin e Projektit dhe në Buxhetin e Projektit që i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje përkatësisht si Shtojca {A} dhe Shtojca {B} ("Dokumentet e Projektit").

Palët hyjnë në këtë Marrëveshje me frymën e Parimeve të Partneritetit të SC, të cilat janë: marrëdhëniet fuqizuese dhe të udhëhequra nga vlerat; transparenca dhe llogaridhënia; përfitimet e ndërsjella dhe plotësueshmëria. Me kërkesën tuaj, mund t'ju dërgohet një kopje e Parimeve të Partneritetit të SC.

#### **1. KOHËZGJATJA**

1.1 Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme duke filluar nga 7 tetor 2022 dhe do të skadojë në 31 dhjetor 2022 nëse nuk vendoset të mbyllet më herët apo të zgjatet, në përputhje me këtë marrëveshje, përmes një marrëveshjeje të ndërsjellë me shkrim. Pikat {4.6}, {6.2},

{6.3}, {11.2}, {11.3}, {11.4}, {11.5}, {14.1}, {14.2}, {14.5}, {15.3(c)}, {21}, {22.3}, {22.7}, {23} dhe {24} do të mbeten të vlefshme edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

## 2. FONDET

2.1 SC miraton dhe garanton dhënien e shumës **898,934.000 ALL (tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër lekë)**. Kjo vlerë nuk mund të përdoret për pagesa TVSH-je. Kjo është pjesa përkatëse e fondit të donatorit, përafërsisht e barasvlershme me {SHUMA NË VALUTËN E DONATORIT} (në varësi të kursit të këmbimit të SC në momentin e kryerjes së pagesës për Partnerin siç është përcaktuar në buxhetin e Projektit në Shtojcën B ("Buxheti i Projektit")).

2.2 Pagesat dhe kthimi i fondeve, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhen në {ALL}.

2.3 Të gjitha raportet e paraqitura nga Partneri do të jenë në {Shqip}.

2.4 Çdo fitim ose humbje përkundrejt vlerës së përgjithshme të marrëveshjes që mund të shkaktohet nga këmbimi si pasojë e forcimit apo dobësimit të CHF - Swiss Franc do të menaxhohet përmes një marrëveshjeje të përbashkët mes palëve. Aty ku do të jetë e nevojshme, kjo Marrëveshjeje do të rinegociohet për të garantuar që hyrjet/daljet të jenë të përbalueshme nga Buxheti i Projektit.

## 3. FINANCIMI I BARASVLERSHËM

3.1 Partneri ka rënë dakord të kontribuojë me një financim të barasvlershëm prej:

**{ 224,734.000 ALL},**

sikurse është detajuar në Buxhetin e Projektit.

## 4. PËRDORIMI I FONDEVE

4.1 Të dyja palët pjesëmarrëse në këtë Marrëveshjeje duhet t'i përmbahen kushteve të Anëtarit të Save the Children dhe atyre të Dhuruesit në Shtojcën {D} si dhe çdo politike, udhëzuesi apo kërkesë tjetër të aplikueshme të Anëtarit të Save the Children dhe Donatorit (në mënyrë përmbljedhëse "Kushtet e Donatorit"). Partneri vërteton se ka lexuar dhe kuptuar kërkesat e parashtruara në Kushtet e Donatorit në Shtojcën {D}.

4.2 Detyrimi për të respektuar Kushtet e Donatorit i shtohet çdo detyrimi tjetër që Partneri mund të ketë brenda kësaj Marrëveshjeje dhe, nëse kjo Marrëveshjeje vendos për Partnerin detyrime më kufizuese ose kushte më të rrepta lidhur me afatet kohore krahasuar me kushtet përkuese të Donatorit, Partneri duhet të respektojë detyrimet apo kushtet e kësaj Marrëveshjeje si dhe kushtet përkuese të Donatorit. Përveç rasteve të parashtruara në fjalinë e mëparshme apo rasteve në të cilat parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshjeje, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje mes asaj që parashikohet nga kjo Marrëveshjeje dhe Kushteve të Donatorit, përparësi do t'u jepet këtyre të fundit.

4.3 Partneri bie dakord që të mos lejohet përdorimi i fondeve të parashikuara nga kjo Marrëveshjeje në asnjë formë që nuk përputhet me Buxhetin e Projektit. Fondet e parashikuara nga kjo Marrëveshjeje nuk mund të përdoren për pagesa TVSH-je.

- 4.4 Çdo devijim nga Buxheti i projektit për të cilin është rënë dakord duhet të miratohet paraprakisht me shkrim nga SC, dhe nuk mund të tejkalojë shumën prej 10% për çdo zë buxheti. Në momentin që shikohet i nevojshëm përdorimi i fondit rezervë prej 5 %, do të kërkohet miratim nga SC për shtesë buxheti.
- 4.5 Në rastet në të cilat SC ka siguruar, në kuadrin e Projektit, mjete jo-monetare, Partneri do të jetë përgjegjës për sigurinë, ruajtjen, mirëmbajtjen, magazinimin dhe sigurimin e tyre dhe do të garantojë përdorimin e tyre në mënyrën e parashikuar. Ky përdorim do të monitorohet, dokumentohet dhe regjistrohet në përputhje me Kushtet e Donatorit dhe me këtë Marrëveshje.
- 4.6 Nëse, gjatë apo pas periudhës së zbatimit të Projektit, (i) ka baza të arsyeshme për të dyshuar që ka pasur parregullsi, përvetësime apo keqpërdorime të fondeve gjatë periudhës së zbatimit të Projektit, dhe (ii) Partneri nuk arrin t'i justifikojë kostot me shpjegime dhe dokumente mbështetës të mjaftueshëm, sikurse është përcaktuar nga SC dhe/ose Donatori (sipas rastit), Partneri duhet t'i rikthejë SC menjëherë fondet në fjalë.
- 4.7 Fondet e dhëna në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të mbahen në llogarinet e thesarit të Partnerit. Çdo interes i përfutur nga fondet e dhëna në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje apo çdo shumë e përfutur apo e marrë si pjesë e veprimtarive të Projektit do të pasqyrohet në mënyrën e duhur nga Partneri në regjistrat e tij kontabël dhe në raportet financiare. Përveç rasteve në të cilat parashikohet ndryshe në Kushtet e Donatorit, Partneri bie dakord t'ia kthejë këto interesa dhe/ose të ardhura SCI.

## 5. PAGESAT

5.1 Fondet e parashikuara nga kjo Marrëveshje do të jepen me këste si vijon:

| Kësti    | Shuma                                   | Data e pagesës së parë  | Kushtet e pagesës  |
|----------|---|---|--------------------|
| I parë   | {{60} % E SHUMËS TOTALE]<br>539,361 ALL | {me firmosjen e kontratës}  | {Sipas kontratës } |
| I fundit | {{40}% E SHUMËS TOTALE]<br>359,573 ALL  | {pas aprovimit të raportit financiar dhe narrativ, situacionit përfundimtar dhe dokumentacionit mbështetës. | {Sipas kontratës } |

5.2 Këstet do të paguhën nga SC, si më poshtë: {Me transferte bankare, sipas të dhenave bankare bashkangjitur}.

5.3 Palët bien dakord që SC mund të bllokojë pagesën apo të ndryshojë datën dhe/ose shumën e një kësti që ka për t'i dhënë Partnerit (përfshirë edhe për të recuperuar pagesa që Partneri apo një palë e tretë në emër të Partnerit duhet t'i bëjnë SC) për çdonjërin nga arsyet e mëposhtme:

- (a) kur ka arsye të qëndrueshme për të menduar se kjo është e nevojshme për të shmangur një shkelje të mundshme të Kushteve të Donatorit (duke përfshirë, por jo

vetëm, rastet që kanë të bëjnë me një përvetësim, keqpërdorim apo parregullsi tjetër në përdorimin e fondeve), politikave të SC të bashkëngjitura këtu, ligjeve apo rregulloreve në fuqi, apo për të shmangur një rrezik që i kanoset sigurisë së stafit, kontraktuesve, përfituesve apo çdo personi tjetër;

- (b) kur është në pritje (i) të dorëzimit nga Partneri të një raporti narrativ dhe financiar të kënaqshëm apo (ii) të një përgjigjeje të kënaqshme nga ana e Partnerit lidhur me parregullsitë e identifikuar nga SC apo nga Donatori gjatë një inspektimi/rishikimi/auditimi;
- (c) kur ka një mospërdorim të plotë të fondeve të buxhetit të miratuar apo një shpenzim që i tejkalon ato.

5.4 Nëse SC i duhet të aplikojë një bllokim apo modifikim të kësteve, ajo do të njoftojë Partnerin me shkrim.

## 6. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

6.1 SC do të:

- (a) Zhvillojë një takim fillestar me stafin e Partnerit dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë lidhur me marrëveshjet brenda Projektit, përfshirë ato që janë përcaktuar nga kjo Marrëveshje dhe shtojcat e saj;
- (b) Garantojë që do të njoftojë në kohë Partnerin për çdo ndryshim apo modifikim në Kushtet e Donatorit, të cilat do të pasqyrohen në një modifikim të kësaj Marrëveshjeje;
- (c) Mbështesë zbatimin e Projektit duke ofruar (kur të kërkohet nga Partneri dhe sikurse është rënë dakord mes palëve) mbështetje për forcimin e kapaciteteve;
- (d) Ofrojë, si pjesë e mandatit të SC për punën me Partnerët, trajnime mbi Politikën e SC për Ruajtjen e Sigurisë së Fëmijëve të Shtojcës (E) për stafin e Partnerit që do të ketë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të vënies në zbatim të Projektit si edhe për pjesën tjetër të stafit të Partnerit, në përputhje me Planin për Forcimin e Kapaciteteve të përfshirë në Pikën 8 në vijim;
- (e) Ofrojë, si pjesë e angazhimit të SC për krijimin e një mjedisi pune të sigurt, pa diskriminime, mungesë respekti apo çdo formë tjetër sjelljeje të papërshtatshme, për të gjithë ata që punojnë për SC ose që bien në kontakt me SC, materiale ose trajnim mbi Politikën e SC kundër Ngacimit, Frikësimit dhe Bullizmit, bashkëngjitur këtij dokumenti si Shtojca F-1, të cilat do të vihen në dispozicion për stafin e Partnerit që do të ketë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të vënies në zbatim të Projektit si edhe për pjesën tjetër të stafit të Partnerit, në përputhje me Planin për Forcimin e Kapaciteteve të përfshirë në Pikën 8 në vijim;
- (f) Ofrojë, si pjesë e angazhimit të SC për të mos lejuar dhe për të luftuar shfrytëzimin seksual dhe abuzimin me të rriturit më të cenueshëm në komunitetet e gjera në të cilat punojmë, trajnime ose materiale mbi Politikën e SC për MShAS (Mbrojtjen nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual) bashkëngjitur këtij dokumenti si Shtojca F-2, të cilat do të vihen në dispozicion për stafin e Partnerit që do të ketë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të vënies në

zbatim të Projektit si edhe për pjesën tjetër të stafit të Partnerit, në përputhje me Planin për Forcimin e Kapaciteteve të përfshirë në Pikën 8 në vijim;

(g) Ofrojë, me kërkesë të Partnerit:

Mbështetje dhe informacion të përshtatshëm lidhur me sigurinë, sikurse është rënë dakord veçmas me shkrim dhe është nënshkruar nga personat e autorizuar të secilës palë;

(i) Materiale burimore të trajnimit për sigurinë të cilat do t'i vërë në dispozicion të Partnerit në Internet;

(ii) Informacione mbi çdo mundësi trajnimi të organizuar nga Save the Children, ku kërkohet prania fizike e pjesëmarrësve

kurdo që këto do të jenë të përshtatshme për veprimtaritë e ndërmarra nga Partneri për Projektin si dhe për mjedisin në të cilin janë duke u ndërmarrë këto veprimtari.

6.2 Partneri do të:

(a) Ndërmarrë veprimtaritë e Projektit në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, përfshirë ligjet e vendit apo vendeve ku Projekti zbatohet si dhe, kur është e rastit, edhe ligjet e Anglisë dhe Uellsit,

(b) Respektojë Kushtet e Donatorit, për të cilat mund të njoftohet nga SC herë pas here, qoftë gjatë zbatimit të Projektit, qoftë pas mbylljes së tij, nëse do të ketë ende kërkesa për t'u përmbushur pas përfundimit të Projektit;

(c) Shmangë përfshirjen në ndonjë nëngrant duke përdorur fondet e Projektit (i) pa marrë një miratim paraprak me shkrim nga SC dhe (ii) pa hyrë në një marrëveshje të shkruar me përfituesin e nëngrantit e cila të përfshijë detyrime të përfituesit të nëngrantit që janë në thelb të ngjashme me ato të Partnerit të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

(d) Njoftojë menjëherë SC për çdo incident që mund të sjellë si pasojë një veprim ligjor kundrejt SC, punonjësve të saj, konsulentëve, vullnetarëve dhe përfaqësuesve të tjerë (përfshirë administratorët e besuar) ose kundrejt Save the Children;

(e) Njoftojë menjëherë SC për çdo burim (përfshirë këtu edhe fonde) që është vënë apo mund t'i vihet në dispozicion për veprimtaritë e Projektit nga financues të tjerë;

(f) Raportojojë menjëherë çdo incident apo dyshim që lidhet me ndonjë formë abuzimi dhe shfrytëzimi, përfshirë, ndër të tjerë, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve dhe të rriturve, apo incidente që kanë të bëjnë me sigurinë në të cilët gjenden të përfshirë (i) anëtarë të stafit të Projektit dhe çdo person që punon për Partnerin apo në emër të Partnerit në këtë Projekt, (ii) përfitues të Projektit, (iii) Veprimtari të Projektit, ose (iv) çdo person me të cilin Partneri (si stafi i tij ashtu edhe përfaqësues të tjerë) hyn në kontakt në kuadrin e Veprimtarive të Projektit;

(g) Raportojojë menjëherë çdo incident apo dyshim që lidhet me një mashtrim, përvetësim apo korrupsion i cili ndikon te Projekti apo burimet e tij.

6.3 Përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të Projektit



- (a) SC ka përgjegjësinë të garantojë që Projekti është duke u zbatuar në përputhje me Kushtet e Donatorit dhe me këtë Marrëveshje. Në këtë përfshihet edhe përgjegjësia për të garantuar që burimet e Projektit janë duke u menaxhuar dhe përdorur në mënyrën e duhur dhe janë të mbrojtura nga devijimi, përvetësimi dhe keqpërdorimi. Për të përmbushur këtë përgjegjësi, SC, dhe Donatori (nëse kjo bën pjesë te Kushtet e Donatorit) ruajnë secili të drejtën për të monitoruar, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet agjentëve të autorizuar, zbatimin e veprimtarive të Projektit dhe përdorimin e burimeve të Projektit. Kjo e drejtë përfshin kryerjen e veprimeve të mëposhtme, me ose pa paralajmërim:
- (i) Inspektimin e mjediseve të Projektit;
  - (ii) Takimet me përfituesit e Projektit dhe aktorë të tjerë;
  - (iii) Krijimin e mekanizmave të pavarur të raportimit të ankesave;
  - (iv) Kryerjen e auditimeve të financave të Partnerit;
  - (v) Kryerjen e investigimeve lidhur me shkelje të pandehura të Kushteve të Donatorit apo të kësaj Marrëveshjeje.
- (b) Partneri bie dakord të bashkëpunojë plotësisht dhe të lehtësojë këto veprimtari monitoruese, qofshin këto me ose pa paralajmërim, duke përfshirë këtu organizimin e vizitave në mjediset e projektit, mundësimin e kontakteve me stafin si dhe aksesin në dokumentet përkatëse financiare dhe dokumentet e Projektit. Partneri gjithashtu bie dakord të vërë në zbatim çdo rekomandim të konkorduar që mund të dalë nga një investigim apo auditim i kryer në kuadrin e kësaj Pike të Marrëveshjes brenda harkut kohor për të cilin do të bihet dakord.
- (c) Palët njohin faktin se të drejtat dhe detyrimet e kësaj Pike u shtohen të drejtave dhe detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në Kushtet e Donatorit.

## 7. MBIKËQYRJA E PROJEKTIT

7.1 SC emëron Z. Genc Burazeri, [genc.burazeri@savethechildren.org](mailto:genc.burazeri@savethechildren.org), si Menaxher Projekti të saj ("Menaxher Projekti i SC"), përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të Projektit, dhe personat e mëposhtëm si staf kyç (çdonjëri "Staf Kyç i SC"):

| Roli                | Emri dhe kontaktet   |
|---------------------|--|
| Eksperti i Edukimit | Z. Kliton Muça, <a href="mailto:kliton.muca@savethechildren.org">kliton.muca@savethechildren.org</a> |

7.2 Partneri emëron Z. Elson Frroku, 0694305085, si Menaxher Projekti të tij ("Menaxher Projekti i Partnerit"), përgjegjës për zbatimin e përditshëm të Projektit dhe dorëzimin e raporteve financiare dhe narrative të kërkuara nga kjo Marrëveshje.

7.3 Nëse një Menaxher Projekti i SC apo një anëtar i Stafit Kyç të SC zëvendësohet, SC i komunikon Partnerit me shkrim kush do të jetë zëvendësuesi. SC garanton që zëvendësuesi i kupton plotësisht afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe ato të Kushteve të Donatorit.

7.4 Nëse një Menaxher Projekti i Partnerit apo një anëtar i Stafit Kyç të Partnerit zëvendësohet, Partneri i komunikon me shkrim SC kush do të jetë zëvendësuesi. Nëse,

sipas Kushteve të Donatorit në fuqi, për kryerjen e zëvendësimit nevojitet një miratim, Partneri do ta kërkojë atë me shkrim nga SC para bërjes së një zëvendësimi të tillë. Partneri garanton që zëvendësuesi i kupton plotësisht afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe ato të Kushteve të Donatorit.

7.5

## 8. PLANI PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE

8.1 Partneri do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të realizuar dhe për të raportuar mbi përmirësimet e mëposhtme, të cilat janë të renditura në planin për forcimin e kapaciteteve të Vlerësimit të Partneritetit (Shtojca {K}) të kryer në Shtator 2022 dhe SC do të mbështesë Partnerin në arritjen e këtyre përmirësimeve:

| Elementi për t'u përmirësuar | Veprimi për të cilin është rënë dakord | Data e propozuar e përfundimit |
|------------------------------|--|--------------------------------|
|                              |  |                                |

## 9. RAPORTIMI

9.1 Partneri do t'i ofrojë SC, brenda afateve të përcaktuara më poshtë, raportet e mëposhtme të cilat do të jenë në formatin e miratuar nga palët që gjendet në Shtojcën {C} ("Formati i Raportimit"):

| Raporti                        | Periudha që mbulon             | Afati i dorëzimit |
|--------------------------------|--------------------------------|-------------------|
| Raporti përfundimtar financiar | 7 tetor 2022 - 31 dhjetor 2022 | 31 dhjetor 2022   |
| Raporti përfundimtar narrativ  | 7 tetor 2022 - 31 dhjetor 2022 | 31 dhjetor 2022   |

9.2 Të gjitha raportet që Partneri i dorëzon SC do të shkruhen në anglisht, përveç rastit në të cilin SC bie dakord me shkrim që mund të hartohen në një gjuhë tjetër.

9.3 Partneri bie dakord të bëjë gjithë modifikimet dhe korrigjimet e nevojshme në një raport brenda 15 ditësh nga kërkesa e SC dhe, në çdo rast, bazuar në çka parashikohet në Kushtet e Donatorit.

9.4 Partneri do të mbajë një regjistër të përditësuar të të gjitha pajisjeve të blera në kuadrin e Projektit. Përpos çdo kërkesë të parashtruar në Kushtet e Donatorit, Partneri do t'i dorëzojë SC këtë regjistër asetesh kurdo që t'i kërkohet nga kjo e fundit si edhe në momentin e dorëzimit të raportit përfundimtar narrativ dhe financiar.

9.5 Secila nga palët bie dakord të njoftojë palën tjetër me shkrim, sa më parë që të jetë e mundur, për çdo ndryshim të rëndësishëm në Projekt apo çdo vështirësi ose vonesë (përfshirë, por jo vetëm, incidentet që lidhen me sigurinë dhe ruajtjen e sigurisë) që mund të cenojë seriozisht respektimin e planifikimit kohor të propozuar dhe/ose zbatimin e Projektit. Në njoftimin që i dërgohet palës tjetër duhet të përfshihet një deklaratë e veprimit të ndërmarre apo që mendohet të ndërmerret si dhe asistencë që nevojitet për zgjidhjen e problemit.

## 10. RISHIKIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

10.1 Përveç të drejtave dhe detyrimeve të palëve të përcaktuara në nenin 6.3 më sipër:

- 10.1.1 SC dhe Partneri do të monitorojnë dhe vlerësojnë së bashku Projektin dhe do të punojnë së bashku për të mbështetur realizimin e vlerësimeve.
- 10.1.2 Partneri do të lehtësojë çdo vizitë të SC, Anëtarit, Donatorit apo përfaqësuesve të tyre që ka të bëjë me Projektin. Palët duhet të bien dakord, duke u treguar të arsyeshme, për datat e vizitave.
- 10.1.3 SC do të garantojë që stafi i saj i programit dhe ai i financës do të ndërmarrin vizita në terren jo më pak se një herë në vit, sipas një programimi për të cilin ka rënë dakord me Partnerin paraprakisht. SC angazhohet t'i paraqesë partnerit me shkrim vërejtjet e saj lidhur me sistemet dhe procedurat programatike, administrative dhe kontabël të Projektit.
- 10.1.4 Partneri dhe SC do të zhvillojnë rregullisht takime koordinuese, të paktën një herë në vit. Në takimet koordinuese, palët do të rishikojnë dhe shkëmbejnë opinionet, mësimet e marra, arritjet dhe metodat e zhvillimit të punës. Gjetjet e këtyre takimeve do të dokumentohen me shkrim dhe do të bashkëndahen nga palët.

## **11 REGJISTRAT FINANCIARË DHE AUDITIMET**

- 11.1 Partneri bie dakord të mbajë libra kontabël dhe regjistra të tjerë financiarë të veçantë në mënyrë që pagesat dhe shpenzimet e kryera në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje të jenë lehtësisht të identifikueshme. Librat kontabël dhe regjistrat e tjerë financiarë duhet të jenë të saktë, të përditësuar dhe të përfshijnë gjithë dokumentet mbështetës përkatës.
- 11.2 Partneri bie dakord të ruajë librat kontabël origjinalë dhe regjistrat e tjerë financiarë për 10 vjet pas përfundimit apo ndërprerjes së parakohshme të kësaj Marrëveshjeje (ose më gjatë, nëse kështu specifikohet në Kushtet e Donatorit). Partneri mund të bëjë kërkesë me shkrim që të gjithë regjistrat financiarë t'i kalojnë SC për t'u ruajtur për periudhën e caktuar dhe kjo kërkesë duhet miratuar me shkrim nga të dyja palët.
- 11.3 Me ose pa një njoftim paraprak, Partneri bie dakord të bashkëpunojë (gjatë kohës së zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe për 10 vjet pas mbarimit të saj) me SC, Shtetin Anëtar dhe/ose çdo person të autorizuar nga SC në çdo auditim apo rishikim të librave kontabël dhe regjistrave të tjerë financiarë që i përkasin kësaj Marrëveshjeje dhe në çdo analizim apo hetim tjetër të arsyeshëm të veprimtarive të Projektit.
- 11.4 Me kërkesë të SC, Partneri bie dakord të përzgjedhë auditorë të pavarur me kualifikimin e duhur, të cilët të konsiderohen të përshtatshëm edhe nga SC, për inspektimin, rishikimin dhe auditimin e librave kontabël dhe regjistrave të tjerë financiarë që i përkasin kësaj Marrëveshjeje dhe të kryejë çdo analizim dhe hetim tjetër të arsyeshëm të veprimtarive të Projektit. Nëse Buxheti i Projektit nuk parashikon koston e të tilla auditimeve, palët do të bien dakord lidhur me si do të mbulohet kjo kosto.
- 11.5 Partneri bie dakord që:
  - (a) Të vërë në zbatim të gjitha rekomandimet që mund të lindin nga një auditim i kryer në kuadrin e Pikës 11, brenda afateve për të cilat është rënë dakord;
  - (b) T'i rimbursojë SC shumën e çdo shpenzimi të konsideruar nga auditorët e pavarur jo të justifikueshëm për arsye të mosrespektimit të ndonjërit prej kushteve të kësaj Marrëveshjeje apo të Kushteve të Donatorit.

- 11.6 Partneri bie dakord të dorëzojë, kur është e rastit dhe e mundur, kopje të deklaratave të tij financiare vjetore të audituara ku pasqyrohen fondet e marra në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, nëse kjo nuk është realizuar me parë nga një auditim i lehtësuar nga SC.

## **12 PROKURIMET**

- 12.1 Të gjitha prokurimet duhet të bëhen duke u bazuar në parimet e çmimit më të volitshëm, transparencës, përgjegjshmërisë dhe konkurrencës së drejtë e trajtimit të barabartë të furnitorëve.
- 12.2 Përveç rasteve në të cilat SC bie dakord me shkrim që të veprohet ndryshe, për prokurimin e të mirave, punimeve dhe shërbimeve që do të blihen me fondet e Projektit, do të aplikohet Procedura e Prokurimit e SC (Shtojca{I}).
- 12.3 Në rastet në të cilat Kushtet e Donatorit për prokurimin e të mirave dhe shërbimeve janë më të rrepta se udhëzimet e specifikuar më lart, përparësi do t'u jepet Kushteve të Donatorit.

## **13 PËRDORIMI DHE HEQJA NGA PËRDORIMI E ASETEVE, PAJISJEVE DHE INVENTARIT**

- 13.1 Të gjitha asetet, pajisjet dhe materialet e inventarit që janë blerë me fondet e Projektit duhet:
- (a) Të përdoren krejtësisht dhe vetëm për Projektin;
  - (b) Të ruhen të sigurt dhe të mbrojtura nga dëmtimet, vjedhja, përvetësimi, përdorimi jo korrekt apo humbja;
  - (c) Të menaxhohen në përputhje me çdo procedurë specifike të Projektit që i bëhet e ditur Partnerit herë pas here.
- 13.2 Të gjitha asetet, pajisjet dhe materialet e inventarit të prokuruar nga Partneri apo të siguruar nga SC mbeten në pronësi të SC, përveç rasteve në të cilat specifikohet ndryshe në Kushtet e Donatorit apo në regjistrin e aseteve.
- 13.3 Shpërndarja është objekt i miratimit paraprak me shkrim të SC dhe i kufizimeve të vëna nga Donatori. Të paktën një muaj para përfundimit të Projektit, Partneri do t'i dorëzojë SC për miratim një plan për heqjen nga përdorimi të të gjitha aseteve, pajisjeve dhe materialeve të inventarit. SC ruan të drejtën për t'i shpërndarë asetet, pajisjet dhe materialet e inventarit që janë në pronësinë e saj në mënyrën që ajo konsideron më të përshtatshme. Heqja nga përdorimi përfshin, por jo vetëm, dhënien e këtyre objekteve Partnerit, shtetit, agjencive shtetërore, komuniteteve apo përfituesve të Projektit.

## **14 PËRGJEGJËSIA LIGJORE, ZHDËMTIMI, SIGURIMET DHE TAKSAT**

- 14.1 SC nuk do të jetë, në asnjë rrethanë apo për asnjë arsye, përgjegjëse dhe as do të mbajë përgjegjësi ligjore për:
- (a) Humbjen apo dëmtimet që, gjatë zbatimit të Projektit, mund të ndodhin apo shkaktohen nga personeli, përfaqësuesit, shitësit/furnitorët, nënkontraktorët apo bashkëpunëtorët e Partnerit;
  - (b) Ankesat, humbjet dhe shpenzimet e një pale të tretë të cilat mund të lindin nga një neglizhencë, papërgjegjshmëri apo veprim i qëllimshëm ose nga mosdhënia e informacioneve që kanë të bëjnë me ecurinë apo ndonjë aspekt tjetër të kësaj

- Marrëveshjeje (përfshirë shtojcat), nga ana e Partnerit apo e cilitdo që vepron në emër të tij;
- (c) Kompensimin për vdekjen, aftësinë e kufizuar apo fatkeqësi të tjera që mund t'i ndodhin stafit, përfaqësuesve, shitësve/furnitorëve, nënkontraktuesve apo bashkëpunëtorëve të Partnerit si pasojë e punës së Partnerit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë shtojcat);
  - (d) Sigurinë dhe mbrojtjen e Partnerit apo punonjësve, konsulentëve, vullnetarëve apo përfaqësuesve të tjerë të tij.
- 14.2 Nëse SC ngarkohet me përgjegjësi ligjore për shkak të ndonjë mangësie të Partnerit lidhur me ndonjë pikë të kësaj Marrëveshjeje apo të ndonjërës prej shtojcave të saj, Partneri merr përsipër të zhdëmtojë SC me anë të burimeve të tij dhe të kujdeset që SC të dalë e pacenuar nga këto përgjegjësi.
- 14.3 Partneri do të:
- 14.3.1 Të nënshkruajë dhe të mbajë polica sigurimesh, duke u bazuar në çka është e arsyeshme dhe e kujdesshme brenda kontekstit të Projektit, me kompani sigurimi të mirënjohura, përgjatë kohëzgjatjes së parashikuar apo dhe periudhës së zgjatjes së Projektit, dhe t'i dorëzojë SC dokumente që vërtetojnë sigurimet në fjalë;
  - 14.3.2 Lidhë të gjitha kontratat e sigurimeve specifike vendore që do t'i duhet të lidhë për të përmbushur kërkesat ligjore të shtetit të përfshirë;
  - 14.3.3 Përmbushë të gjitha kërkesat specifike të Donatorit lidhur me sigurimet dhe do t'ia kalojë këtë detyrim edhe nënkontraktuesve të mundshëm;
  - 14.3.4 Zhdëmtojë SC në rast se SC konsiderohet nga Donatori përgjegjëse për mosrespektimin e detyrimeve që lidhen me sigurimet.
- 14.4 Partneri dhe SC gjithashtu bien dakord lidhur me kërkesat për sigurimin e pajisjeve të prokuruar nga Partneri apo të ofruara nga SC për qëllimet e Projektit. Primet e sigurimit do të përfshihen në Buxhetin e Projektit në mënyrën më të përshtatshme.
- 14.5 Partneri do të ketë përgjegjësinë ligjore për pagesën e të gjitha taksave, primeve dhe të zbritshmeve që lidhen me sigurimin dhe që mund të lindin nga pagesat e bëra në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.
- 14.6 Partneri duhet të garantojë që të gjitha shpenzimet të kryhen duke respektuar Kushtet e Donatorit lidhur me TVSH-në dhe taksat apo detyrimet e tjera në fuqi. Kur nuk ekziston ndonjë kërkesë specifike, të gjitha të mirat dhe shërbimet e paraqitura në Buxhetin e Projektit duhet të përfshijnë TVSH-në e parashikuar ose çdo taksë apo detyrim tjetër.

## 15 POLITIKAT E SAVE THE CHILDREN

### 15.1 Ruajtja e sigurisë së fëmijëve

- (a) Politikat e SC për Ruajtjen e Sigurisë së Fëmijëve (Shtojca (E)) janë pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje. Partneri duhet të lexojë dhe kuptojë këto politika përpara se të firmosë këtë Marrëveshje dhe bie dakord që t'i ndjekë ato plotësisht.
- (b) Partneri do të garantojë që:
  - (i) Stafi i tij i përfshirë në Projekt do të lexojë dhe kuptojë Politikat e SC për Ruajtjen e Sigurisë së Fëmijëve dhe do të ndjekë trajnimin mbi Politikat e SC për Ruajtjen e Sigurisë së Fëmijëve që do të ofrojë SC në zbatim të pikës 6.1 **Error! Reference source not found.**;

- (ii) Çdo shqetësim për mosrespektime të mundshme të Politikave të SC për Ruajtjen e Sigurisë së Fëmijëve do të silltet menjëherë nën vëmendjen e Save the Children. Palët do të bien dakord lidhur me si këto shqetësime do të hetohen në një mënyrë të sigurt, të fshehtë dhe të shpejtë. Çdo hetim që lidhet me shkelje të Politikave të SC për Ruajtjen e Sigurisë së Fëmijëve duhet të mbajë parasysh interesat më të larta dhe sigurinë e fëmijëve të përfshirë.
- (iii) Partneri njuh dhe zbaton qasjen e tolerancës zero që SC aplikon ndaj çdo forme abuzimi, shfrytëzimi dhe keqtrajtimi të fëmijëve.

### 15.2 Mbrojtja nga Ngacmimet, Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi

- (a) Të gjitha Politikat e SC Kundër Ngacmimit, Frikësimit dhe Bullizmit (Shtojca {F-1}) dhe Politikat e SC për MShAS (Mbrojtjen nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual) (Shtojca {F-2}) janë pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje. Partneri duhet të lexojë dhe kuptojë këto politika përpara se të firmosë këtë Marrëveshje dhe bie dakord që t'i ndjekë ato plotësisht.
- (b) Partneri do të garantojë që:
  - (i) Stafi i tij i përfshirë në Projekt do të lexojë dhe kuptojë të gjitha Politikat e SC Kundër Ngacmimit, Frikësimit dhe Bullizmit dhe Politikat e SC për MShAS (Mbrojtjen nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual) dhe do të konsultojë materialet dhe/ose ndjekë trajnimin që SC do të ofrojë në takimin fillestar në zbatim të pikës 6.1 **Error! Reference source not found.** dhe (f);
  - (ii) Çdo shqetësim për mosrespektime të mundshme të Politikave të SC Kundër Ngacmimit, Frikësimit dhe Bullizmit dhe Politikave të SC për MShAS (Mbrojtjen nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual) do të silltet menjëherë nën vëmendjen e Save the Children. Palët do të bien dakord lidhur me si këto shqetësime do të hetohen në një mënyrë të sigurt, të fshehtë dhe të shpejtë. Çdo hetim që lidhet me shkelje të ndonjërës prej këtyre politikave duhet të mbajë parasysh interesat më të larta dhe sigurinë e personave të përfshirë.
  - (iii) Partneri njuh dhe zbaton qasjen e tolerancës zero që SC aplikon ndaj çdo forme abuzimi, shfrytëzimi dhe keqtrajtimi ndaj të rriturve.

### 15.3 Mashtrimet, Ryshfetet dhe Korrupsioni

- (a) Partneri garanton që asetet, fondet dhe burimet që lidhen me Projektin të jenë të mbrojtura nga të gjitha format e mashtrimit, korrupsionit, humbjes, përvetësimit apo keqpërdorimit.
- (b) Partneri njuh dhe zbaton qasjen e tolerancës zero që SC aplikon ndaj mashtrimit, ryshfeteve dhe praktikave korruptuese dhe ndjek të gjitha ligjet, statutet, rregulloret dhe kodet e aplikueshme lidhur me mashtrimin, ryshfetin dhe korrupsionin. Politikat e SC për Mashtrimin, Ryshfetin dhe Korrupsionin (Shtojca {G}) janë pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje dhe Partneri bie dakord që t'i ndjekë ato plotësisht.

- (c) Partneri njofton menjëherë SC nëse bëhet me dije për raste mashtrimi, rryshfeti apo korrupsioni, të identifikuar, të dyshuar apo të tentuar, që cenojnë fondet, emrin, stafin apo asetet e SC. Partneri menjëherë heton dhe ndërmerr veprime kundër çdo mashtrimi, rryshfeti apo korrupsioni që cenon këtë Projekt dhe mban SC të informuar lidhur me ecurinë e këtyre veprimeve. Nëse SC zgjedh të kryejë një hetim lidhur me një incident të raportuar, Partneri bashkëpunon plotësisht me SC në lidhje me hetimin në fjalë, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.
- (d) Partneri garanton që as Partneri vetë dhe as ndonjë prej stafit, përfaqësuesve, nënkontraktorëve, furnitorëve/shitësve dhe bashkëpunëtorëve të tij që kanë lidhje me Projektin:
  - (i) Nuk kanë dhënë apo pranuar dhe nuk kanë ofruar apo rënë dakord të japin apo pranojnë asnjë lloj pagese, dhurate apo përfitimi tjetër (d.m.th. rryshfeti) për të shtyrë dikë të nënshkruajë një kontratë dhe nuk kanë vepruar në mënyrë të papërshtatshme apo kanë shpërblyer ndokënd për nënshkrimin e ndonjë kontrate;
  - (ii) Nuk do të japin apo pranojnë dhe nuk do të ofrojnë apo bien dakord të japin apo pranojnë asnjë lloj pagese, dhurate apo përfitimi tjetër (d.m.th. rryshfeti) për të shtyrë dikë të nënshkruajë një kontratë dhe nuk do të veprojnë në mënyrë të papërshtatshme apo të shpërblejnë ndokënd për nënshkrimin e ndonjë kontrate;
- (e) As Partneri dhe as stafi, agentët, përfaqësuesit, nënkontraktuesit, furnitorët/shitësit dhe bashkëpunëtorët e tij nuk do të pranojnë, për interesat e tyre personale, asnjë komision shitjeje, ulje apo pagesë ose përfitim të ngjashëm brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

#### 15.4 Terrorizmi dhe Palët Ndaluara

- (a) Partneri nuk do të përfshihet në asnjë lloj marrëdhënieje si dhe nuk do t'i ofrojë, as në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as jo të drejtpërdrejtë, fonde, burime financiare apo mbështetje asnjë individi apo enti që është:
  - (i) I përfshirë në ndonjë listë personash/entesh të piketuar e cila mund të jetë publikuar në kuadrin e sanksioneve ekonomike ose financiare të administruara nga një qeveri, nga BE apo nga OKB dhe/ose është deklaruar i jashtëligjshëm sipas legjislacionit kundër terrorizmit të Mbretërisë së Bashkuar ose një legjislacioni ekuivalent në {JURIDIKSIONIN E ZYRËS KOMBËTARE} (të quajtur në mënyrë përmbledhëse "Ligjet e Sanksioneve Ekonomike") ose që është i lidhur në ndonjë formë tjetër me terrorizmin;
  - (ii) pjesë e një qeverie të një vendi apo territori objekt i një embargoje të përgjithshme import-eksporti, financiare apo të investimeve, sipas Ligjit të Sanksioneve Ekonomike ("Territori i Sanksionuar");
  - (iii) në pronësinë apo nën kontrollin e ndonjë prej të mësipërmeve ose vepron në emër të tyre;
  - (iv) i vendosur apo operon në një Territor të Sanksionuar;
  - (v) në ndonjë formë tjetër i piketuar si "Palë e Ndaluar" sipas ndonjërit prej Ligjeve të Sanksioneve Ekonomike, në lidhje me këtë Marrëveshje,

përveç rasteve në të cilat këtë e lejon Ligji i Sanksioneve Ekonomike.

- (b) Partneri do t'i dorëzojë SC, për qëllime verifikimi, emrat e plotë dhe datat e plota të lindjes të drejtorëve të tij, administratorëve të besuar (nëse ka) dhe stafit të tij kyç. Për të shmangur dyshimet, kjo kërkesë nuk aplikohet për përfituesit. Partneri informon SC, sa më parë që të jetë e mundur, kur një drejtor, administrator i besuar (nëse ka) apo anëtar i stafit kyç largohet nga Partneri apo nuk është më drejtor, administrator i besuar (nëse ka) apo anëtar i stafit kyç dhe i dërgon SC, për qëllime verifikimi, emrat dhe datat e lindjes të drejtorëve, administratorëve të besuar apo anëtarëve të rinj të stafit kyç menjëherë pasi personi i ri është emëruar apo punësuar, siç mund të jetë rasti. Partneri konfirmon se ka informuar secilin prej personave në fjalë për faktin që të dhënat e tij/saj personale do të bashkëndahen me SC dhe për qëllimin për të cilin këto të dhëna bashkëndahen.
- (c) Partneri garanton që asnjë nga fondet ose burimet e Projektit nuk do t'i transferohet një personi apo organizate banues/të vendosur në një Territor të Sanksionuar apo puna e të cilëve organizohet në një Territor të Sanksionuar, gjë që është, në çdo rast, një shkelje e Ligjit të Sanksioneve Ekonomike.
- (d) Partneri informon menjëherë SC nëse, gjatë periudhës së zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, bëhet me dije për ndonjë lidhje të çfarëdolloj natyre mes Partnerit dhe një Pale të ndaluar apo çdo organizate apo individ që mund të perceptohet si e/i lidhur me ndonjë lloj forme me terrorizmin apo që figuron në ndonjë listë sanksionesh, përfshirë, por jo vetëm, rastet e identifikuar, të dyshuara apo të mbetura në tentativë (qofshin të drejtpërdrejta ose jo) të:
  - (i) Transaksioneve financiare apo marrëveshjeve të tjera me një Palë të Ndaluar apo një grup terrorist;
  - (ii) Devijimit të aseteve, fondeve apo burimeve të Projektit drejt një Pale të Ndaluar apo një grupi terrorist.

15.5 Partneri duhet të garantojë që çdo person që ka lidhje me Projektin, i cili është duke ofruar shërbime apo të mira në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje ose është një nënkontraktues, vepron mbi bazën e një kontrate të shkruar e cila i imponon këtij personi dhe bën që të mos shkelen prej tij kushte të barasvlershme me ato që i imponohen vetë Partnerit në Pikën 15, përfshirë gjithë nënpikat. Partneri do jetë përgjegjës për respektimin dhe zbatimin nga ana e këtyre personave të të gjitha këtyre kushteve dhe do të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë përballë SC për çdo mosrespektim nga ana e tyre të ndonjërit prej kushteve.

## 15.6 Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Skllavëria Moderne

- 15.6.1 Politikat e SC për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Skllavërinë Moderne (Shtojca {H}) janë pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje. Partneri garanton që do të ketë lexuar dhe kuptuar këto politika përpara nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord që t'i ndjekë ato plotësisht.
- 15.6.2 Partneri njih dhe zbaton qasjen e tolerancës zero që SC aplikon ndaj praktikave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe skllavërisë moderne.
- 15.6.3 Partneri njofton menjëherë SC nëse, gjatë periudhës së zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, bëhet me dije ose dyshon që, në organizatën e tij apo në çdo organizatë tjetër që ka të bëjë me Projektin, janë duke u kryer praktika të skllavërisë



moderne ose trafikimit të qenieve njerëzore dhe ofron bashkëpunimin e tij të plotë në çdo hetim të ndërmarrë nga SC.

#### **15.7 Bilbilfryrja**

SC do të dëgjojë, do të respektojë dhe do të veprojë në mënyrën e duhur për çdo raportim nga ana e stafit të Partnerit apo palëve të treta që ka të bëjë me veprime të pandershme ose praktika të rrezikshme, joetike ose të paligjshme të kryera nga SC apo stafi i saj (përfshirë dyshimet për mashtrime) apo nga stafi ose përfaqësuesit e Partnerit.

### **16 UDHËZIMET FINANCIARE**

16.1 Partneri bie dakord të ndjekë politikat dhe procedurat e tij financiare si dhe të gjitha Kushtet e Donatorit në fuqi.

16.2 Në rastet e konfliktit midis politikave dhe procedurave të Pikës 16.1 dhe atyre të përfshira në Kushtet e Donatorit, përparësi do t'i jepet asaj që parashikon nivelin më të lartë të kontrollit të brendshëm. Partneri mund të kërkojë gjithashtu sqarime nga SC me shkrim përpara se të ndërmarrë çfarëdo veprimi lidhur me ndonjë politikë apo procedurë financiare.

### **17 PUBLICITETI DHE VIZIBILITETI**

17.1 Udhëzimet mbi përdorimin e emrit dhe logos së SC dhe Donatorit do të merren nga SC dhe çdo përdorim i tyre do të miratohet me shkrim nga SC paraprakisht; për sa i përket emrit dhe logos së Donatorit, do të ndiqen Kushtet e Donatorit.

17.2 Përveç respektimit të të gjitha Kushteve të Donatorit që lidhen me vizibilitetin dhe komunikimet e jashtme, Partneri do të ndjekë gjithashtu edhe të gjitha strategjitë e komunikimit për të cilat ka rënë dakord me SC dhe së paku do të përfshijë emrin dhe logon e Donatorit dhe SC në çdo botim të jashtëm të prodhuar në kuadrin e Projektit.

17.3 Përveç rasteve në të cilat bihet dakord ndryshe me shkrim, Partneri, përpara publikimit të çfarëdo materiali apo dokumenti që përmban emrin apo logon e SC apo të Donatorit (dhe/ose që përmban apo është i bazuar në ndonjë formë në informacione apo të dhëna të përfuara, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, nga një program, projekt apo marrëveshje që përfshin Save the Children apo përfituesit e saj) do t'ia paraqesë këtë material apo dokument SC për miratim (dhe, nëse është rasti, për rishikim).

17.4 Përgjatë zbatimit të projektit, Partneri nuk do të bëjë asgjë që mendohet se mund të dëmtojë reputacionin e SC apo Donatorit.

### **18 PRONËSIA INTELEKTUALE**

18.1 Në zbatim të Pikës 17.3 dhe pa cenuar asnjë Kusht të Donatorit që ka të bëjë me pronën intelektuale, çdo e drejtë pronësie intelektuale mbi materialet e përgatitura nga cilado palë e kësaj Marrëveshjeje, apo në emër të cilësdo palë, posaçërisht për këtë Projekt, do t'i mbetet palës në fjalë, por do t'i jepet palës tjetër licenca, në nivel mbarëbotëror dhe në formë të përhershme, të pakthyeshme dhe pa pagesë, për t'i përdorur ato apo për të lejuar të tjerë t'i përdorin për qëllimet e këtij Projekti.

18.2 Në rastet në të cilat SC i ka dhënë Partnerit të drejtën për të përdorur për qëllime të projektit cilëndo nga pronat e saj intelektuale, Partneri do të pushojë menjëherë së ushtruari këto të drejta pronësie me mbarimin e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve

në të cilat SC ka udhëzuar ndryshe me shkrim, dhe do t'i kthejë apo eliminojë Çdo material që përfaqëson apo përmban këto prona intelektuale, sikurse i është kërkuar nga SCI.

## **11. MBROJTJA E TË DHËNAVE**

- 19.1 Partneri garanton që, për sa i përket çdo informacioni të identifikuar si individual ("të Dhënat Personale") që ka të bëjë me përfituesit e projektit ose persona të tjerë dhe përpunohet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, ai:
- 19.1.1 do t'i përpunojë këto të Dhëna Personale jo më shumë sesa është e nevojshme për qëllimet e parashtruara në këtë Marrëveshje;
- 19.1.2 do t'i përpunojë të dhënat duke marrë masa sigurie që përputhen me nivelin e rrezikut që paraqet përhapja apo aksesit i paautorizuar i këtyre të dhënave ose humbja e tyre;
- 19.1.3 do t'u japë përfituesve të Projektit informacion të qartë lidhur me si do të përdoren të Dhënat Personale të tyre, me kë do të ndahen, sa kohë do të mbahen, nëse do të transferohen jashtë juridiksionit si dhe çdo të drejtë që individit ka lidhur me to;
- 19.1.4 do të respektojë çdo ligj dhe rregullore për mbrojtjen e të dhënave ose për privatësinë që i duhet të respektojë në cilësinë e Partnerit, duke përfshirë, por jo vetëm, detyrimin për të marrë pëlqimin e personave për të përpunuar të dhënat ose për t'i transferuar ato në nivel ndërkombëtar.
- 19.2 Nëse, për qëllime monitorimi dhe vlerësimi ose për qëllime auditimi që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje, Partnerit do t'i duhet të ndajë me SC ose me një Donator ndonjë informacion lidhur me përfituesit e Projektit, përpara se këto informacione të ndahen, të Dhënat Personale duhet të bëhen anonime, përveç rasteve në të cilat anonimati nuk i shërben qëllimit për të cilin ky informacion po ndahet, raste në të cilat do të ndahet vetëm minimumi i të Dhënave Personale i nevojshëm për arritjen e këtij qëllimi.
- 19.3 Në qoftë se, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, Partneri do të ketë të nevojshme të ndajë me SC të dhëna të identifikueshme ose do t'i duhet të mbledhë të Dhëna Personale në emër të SC, Partneri duhet të diskutojë me SC dhe të sigurohet që të gjitha informacionet e specifikuar nga SC të jenë të përfshira në formularin e pëlqimit ose në informacionin mbi privatësinë që do t'i jepet përfituesve në momentin e marrjes së të dhënave.
- 19.4 Çdo transferim i të Dhënave Personale të përfituese nga Partneri te SC ose te një Donator do të bëhet përmes një metode transmetimi të sigurt.
- 19.5 Në rastet në të cilat Partneri do të ndajë të Dhëna Personale me një nënkontraktues, në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes, ose nënkontraktuesi do të mbledhë të Dhëna Personale në emër të Partnerit, Partneri do të sigurohet që nënkontraktuesi të ketë nënshkruar një marrëveshjeje me shkrim e cila të përmbajë detyrime ekuivalente me ato të kësaj Pike 19.
- 19.6 Partneri duhet të njoftojë SC, pa vonesa të pajustificuara, nëse vihet në dijeni për ndonjë trajtim, humbje, dëmtim apo shkatërrim të paautorizuar ose të paligjshëm, të të Dhënave Personale të mbledhura ose të përpunuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të takohet menjëherë me SC për të diskutuar mënyrat me të cilat mund të reduktojë rreziqet që kjo mund t'i shkaktojë individëve.

## **20 NDRYSHIMET NË MARRËVESHJE**

- 20.1 Ndryshimet në këtë Marrëveshje apo në shtojcat e saj do të bëhen me shkrim dhe do të firmosen nga personat e autorizuar për të vepruar në emër të secilës palë.
- 20.2 Në rastet në të cilat nevojitet edhe miratimi i Donatorit, SC mban përgjegjësinë për të bërë kërkesë për këtë miratim përpara se të konfirmojë ndryshimin me Partnerin.

## **21 FSHEHTËSIA**

- 21.1 SC dhe Partneri bien dakord të bashkëndajnë informacionet lidhur me Projektin (përfshirë informacionet mbi rreziqet që kanë të bëjnë me sigurinë). Përveç rasteve në të cilat bashkëndarja e tyre me Donatorin, Qeverinë apo autoritete të tjera statutoare apo rregullatore ose me gjykatën e juridiksionit kompetent është e detyrueshme mbi bazën e ligjeve, rregulloreve apo detyrimeve të tjera ligjore në fuqi, kjo Marrëveshje dhe përmbajtja e saj (përfshirë shtojcat) do të mbahen të fshehta dhe nuk do të bashkëndahen me askënd pa miratimin paraprak të palës tjetër

## **22 MODIFIKIMI, PEZULLIMI APO NDËRPRERJA E MARRËVESHJES**

- 22.1 Ndërprerja apo pezullimi i kësaj Marrëveshjeje
- (a) Secila nga palët mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje duke bërë një paralajmërim me shkrim një muaj më parë.
  - (b) Pa cenuar të drejtat e tjera të saj, SC mund të pezullojë apo ndërpresë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm duke i dërguar Partnerit një njoftim me shkrim kur:
    - (i) Partneri, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë përmes stafit të tij, përfaqësuesve apo një pale të tretë, shkel ndonjë nga detyrimet e tij në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, përfshirë, por jo vetëm, çdo shkelje të Kushteve të Donatorit dhe të shtojcave të tjera, dhe nuk arrin ta riparojë këtë shkelje brenda 15 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit nga SCI;
    - (ii) Për një arsye të çfarëdoshme, Partneri nuk është në gjendje të vazhdojë zbatimin e Projektit nën kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje, përfshirë shtojcat e saj;
    - (iii) Një publicitet që ka të bëjë me Partnerin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë cenon materialisht veprimtaritë e SCI, Donatorit apo vetë Partnerit;
    - (iv) Verifikohet ndonjë keqpërdorim apo përvetësim i fondeve ose aseteve të Projektit, ose ndonjë mashtrim apo ndonjë problem që ka të bëjë me ruajtjen e sigurisë së fëmijëve, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual ose veprime të tjera të kryera në lidhje me Projektin të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e SC apo të dëmtojë interesat materiale të saj;
    - (v) Një gjë e tillë kërkohet në zbatim të ligjeve apo kërkesave të aplikueshme të autoriteteve rregullatore apo të vendimit gjyqësor të një gjykate të juridiksionit kompetent;
    - (vi) Ndërprerja ose pezullimi janë në përputhje me Kushtet e Donatorit.
- 22.2 Modifikimi, pezullimi apo ndërprerja e Marrëveshjes së Donatorit

- (a) Në rast se Marrëveshja e Donatorit modifikohet, ndërpritet apo pezullohet nga Donatori, SC mundet, me vullnetin e saj, të modifikojë, ndërpresë apo pezullojë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm, në çdo moment, duke i bërë Partnerit një njoftim me shkrim ku të japë arsyet që ai njuh për modifikimin, ndërprerjen apo pezullimin në fjalë.
- (b) Në rastet në të cilat kjo Marrëveshje modifikohet, ndërpritet apo pezullohet në zbatim të Pikës 22.2(a), Partneri do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të modifikuar, pezulluar apo ndërprerë veprimtaritë e ofruara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë modifikimin, pezullimin apo ndërprerjen e nënkontratave të mundshme) në kohë dhe në një mënyrë të mirorganizuar, sikurse ka rënë dakord me SC, dhe do të minimizojë çdo shpenzim të ardhshëm në rastin e ndërprerjes apo pezullimit të kësaj Marrëveshjeje.

22.3 Nëse kjo Marrëveshje ndërpritet në zbatim të Pikës **Error! Reference source not found.**:

(a) Partneri:

- (i) Do të ndërpresë veprimtaritë e Projektit dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të ruajtur dhe mbrojtur gjithë punën e realizuar deri në atë moment dhe do t'i përmbahet udhëzimeve të SC lidhur me këto veprimtari;
  - (ii) Do të bëjë, pa vonuar, një rakordim të llogarisë me shpenzimet e financuara nga granti deri në ditën e ndërprerjes. Kjo do të përfshijë çdo shpenzim të mëtejshëm apo angazhim pas datës së ndërprerjes, që vlerësohet i pashmangshëm apo që nuk është e arsyeshme të pritët nga Partneri që ta mbulojë vetë;
  - (iii) Do t'i dorëzojë SC një raport narrativ dhe financiar përfundimtar brenda 30 ditësh nga data e ndërprerjes;
  - (iv) Do t'i kthejë SC asetet dhe pajisjet e blera me fondet e vëna në dispozicion në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje brenda 30 ditësh nga data e ndërprerjes, përveç rasteve në të cilat të dyja palët kanë rënë dakord ndryshe me shkrim;
  - (v) Do t'i kthejë SC të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 30 ditësh nga data e ndërprerjes.
- (b) Pas ndërprerjes, SC do të kryejë pagesat që i detyrohet Partnerit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje për veprimtaritë e grantit, prurjet dhe rezultatet a arritura që ajo konsideron të kënaqshme deri në datën e ndërprerjes. SC nuk do të ketë, pas datës efektive të njoftimit për ndërprerjen e parakohshme, detyrimin të paguajë për shpenzimet e Partnerit që mund të konsiderohen të shmangshme apo që vlerësohet që Partneri mund të mbulojë vetë.
- (c) Veç kësaj, SC ruan të drejtën të rekuperojë, në datën e ndërprerjes, çdo shumë të parapaguar e cila nuk është shpenzuar apo që do të kish qenë e arsyeshme të mos ishte shpenzuar ose që nuk pranohet nga Donatori, mbi bazën e Kushteve të Donatorit, për shkak të një shkeljeje, nga ana e Partnerit, të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje (përfshirë shtojcat e saj), ose t'i zbresë këto shuma nga shumat që ajo vetë ka ende për të paguar.

22.4 Nëse kjo Marrëveshje pezullohet për çfarëdolloj arsyeje të Pikës 22, me përjashtim të rasteve në të cilat palët kanë rënë dakord me shkrim që të veprohet ndryshe:

(a) Partneri:

(i) Do të ndërpresë veprimtarinë e Projektit dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të ruajtur dhe mbrojtur gjithë punën e realizuar deri në atë moment dhe do t'i përmbahet udhëzimeve të SC lidhur me këto veprimtari;

(ii) Do të bëjë, pa vonuar, një rakordim të llogarisë me shpenzimet e financuara nga granti deri në ditën e pezullimit. Kjo do të përfshijë çdo shpenzim të mëtejshëm apo angazhim pas datës së pezullimit, që vlerësohet i pashmangshëm apo që nuk është e arsyeshme të pritët nga Partneri që ta mbulojë vetë;

(b) Pas pezullimit, në rastet në të cilat e ka ligjërisht të mundshme, SC do të kryejë pagesat që i detyrohet Partnerit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje për veprimtarinë e grantit, prurjet dhe rezultatet a arritura që ajo konsideron të kënaqshme deri në datën e pezullimit. SC nuk do të ketë, pas datës efektive të njoftimit për pezullimin, detyrimin të paguajë për shpenzimet e Partnerit që mund të konsiderohen të shmangshme apo që vlerësohet që Partneri mund të mbulojë vetë.

Palët bien dakord veçmas me shkrim për sa u përket hapave të ardhshëm lidhur me detyrimet për të raportuar dhe kthimin e aseteve dhe pajisjeve në rast pezullimi.

## 22.5 Forcat Madhore

### 22.5.1 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

Me **Forcë Madhore** do të nënkuptohet çdo ndryshim thelbësor i rrethanave përkundrejt momentit të nisjes së Projektit, i cili del jashtë kontrollit të palëve dhe e bën përmbushjen e detyrimeve të palës së përfshirë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje të pamundur apo kaq të ndërlikuar sa të konsiderohet efektivisht e pamundur për rrethanat e dhëna.

**Ngjarjet që konsiderohen Forca Madhore** përfshijnë, por jo vetëm:

- (a) Luftërat (qofshin këto të deklaruara apo jo) dhe veprimtarinë e tjera armiqësore, pushtimet, veprime të armiqve të huaj, revoltat, revolucionet, aktet e terrorizmit, kryengritjet, pushtetin ushtarak ose uzurpimin e pushtetit, luftërat civile;
- (b) Grevat, lokautet, rebelimet, trazirat apo rrëmuajt (përveçse nëse shkaku i tyre janë veprimet e Partnerit);
- (c) ndryshimet e ligjit (përfshirë, por jo vetëm, prezantimin ose ndryshimet në Ligjin e Sanksioneve Ekonomike);
- (d) tërmetet, përmytjet, furtunat dhe fatkeqësi të tjera natyrore.

22.5.2 Nëse njëra nga palët gjykon se ka ndodhur një Ngjarje e konsiderueshme Forcë Madhore e cila mund të cenojë përmbushjen e detyrimeve të saj në kuadrin e kësaj

Marrëveshjeje (përfshirë shtojcat e saj), ajo duhet të njoftojë palën tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, në çdo rast, brenda 10 ditësh nga momenti në të cilin është e arsyeshme të besohet që është bërë me dije për fillimin e ngjarjes në fjalë ("Njoftim për Forcë Madhore"). Njoftimi për Forcë Madhore duhet të përfshijë një përshkrim të plotë e të hollësishëm të rrethanave të krijuara dhe efekteve të tyre.

- 22.5.3 Pavarësisht asaj çka parashikohet në Pikën 22, me nxjerrjen e një Njoftimi për Forcë Madhore dhe me miratimin e palës tjetër, miratim të cilin pala tjetër nuk mund ta refuzojë pa pasur arsye të qëndrueshme, palës që nxjerr njoftimin do t'i justifikohet mospërmbushja e detyrimeve të saj në kuadrin e Marrëveshjes për sa kohë do të zgjasë gjendja e Forcës Madhore. Nëse Ngjarja e konsiderueshme Forcë Madhore zgjat për më shumë se dy muaj, SC mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje duke i dërguar Partnerit një njoftim me shkrim. Kjo ndërprerje nuk do të cenojë të drejtat e palëve lidhur me shkeljet e kësaj Marrëveshjeje që kanë ndodhur para ndërprerjes.

## 22.6 [PIKË OPSIONALE QË MUND TË PËRFSHIHET NËSE EKZISTON NJË NIVEL I LARTË RREZIKU QË KA TË BËJË ME SIGURINË OSE NJË MASHTRIM TË MUNDSHËM]

**Pezullim ose ndërprerje për shkak të një rreziku që ka të bëjë me sigurinë ose mashtrimin**

Nëse:

- (a) ekziston një rrezik që ka të bëjë me sigurinë në zonat gjeografike të përfshira në Projekt ose
- (b) dyshohet që, brenda operacioneve të Projektit, ekziston një mashtrim sistematik, korrupsion apo devijim fondesh që mund të dëmtojnë ndjeshëm vlerën zhvillimore të Projektit ose të paraqesin një nivel të papranueshëm rreziku për ndonjërin nga palët,

palët duhet të konsultohen në rastin më të parë mbi masat për zgjidhjen e problemit dhe identifikimin e kanaleve të mundshme të veprimit. Në rast se palët bien dakord për pezullimin ose ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje, do të vihen në zbatim pikat 22.3 dhe 22.4 me modifikimet e nevojshme.

## 23 LIGJI NË FUQI

- 23.1 Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jokontraktual që lind prej kësaj Marrëveshjeje apo që lidhet me të do të udhëhiqet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin anglez.
- 23.2 Duke iu përmbajtur gjithmonë procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në Pikën 24 në vijim, çdo konflikt apo mosmarrëveshje që do të lindë nga kjo Marrëveshje apo në lidhje me të, i cili/e cila nuk do të mund të zgjidhet në mënyrë miqësore mes palëve, do të çohet në gjykatën e Anglisë dhe Uellsit.

## 24 MEKANIZMAT E ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE

- 24.1 Si SC ashtu edhe Partneri bien dakord t'i zgjidhin të gjitha keqkuptimet apo konfliktet që mund të lindin përgjatë vënies në zbatim të Projektit në mënyrë miqësore. Nëse, pasi janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të zgjidhur një konflikt në formë jo zyrtare,

ndonjëra nga palët mendon se konflikti nuk mund të zgjidhet në këtë mënyrë, ajo mund të njoftojë se po e referon konfliktin për zgjidhje në nivelet e përshtatshme, në përputhje me procedurën e përshkallëzimit në vijim.

24.2 Nivelet e rekomanduara të procedurës së përshkallëzimit janë:

- (a) Niveli 1: Menaxheri i Projektit i SC dhe Menaxheri i Projektit i Partnerit.
- (b) Niveli 2: Drejtori ekzekutiv i SC dhe pozicioni i barasvlershëm i Partnerit.
- (c) Niveli 3: Drejtori rajonal i SCI dhe pozicioni i barasvlershëm i Partnerit.

24.3 Nëse palët nuk janë të afta ta zgjidhin konfliktin brenda tridhjetë ditësh nga data e paraqitjes së çështjes në nivelin I të përshkruar më lart, ato do të përpiqen ta zgjidhin konfliktin me ndërmjetësim, në përputhje me Modelin e Procedurës së Ndërmjetësimit të Qendrës për Zgjidhjen e Konflikteve (QZK). Për të filluar ndërmjetësimin, pala që e nis atë e para duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër dhe t'i nisë një kopje të njoftimit QZK-së. Ndërmjetësimi do të nisë jo më vonë se 30 ditë pas dërgesës së njoftimit. Palët bien dakord të mos nisin procedura gjyqësore lidhur me konfliktin përpara se të jenë përpjekur ta zgjidhin konfliktin me ndërmjetësim dhe ky ndërmjetësim të jetë ndërprerë apo të ketë dështuar. Përveç rasteve në të cilat është rënë dakord ndryshe me shkrim, kostot e ndërmjetësimeve të kryera në zbatim të kësaj Pike do të ndahen në mënyrë të barabartë nga palët.

24.4 Asgjë e parashikuar në këtë Marrëveshje nuk do t'i ndalojë palët të ndërmarrin veprimin që gjykojnë më të përshtatshëm (përfshirë paraqitjen e një kërkesë në gjykatat kompetente) për marrjen e masave kufizuese apo masave të tjera të emergjencës apo provizore.

## 25 PËRFUNDIMI I PROJEKTIT

25.1 Në përfundim të Projektit, pas miratimit të raporteve financiare dhe narrative përfundimtare, shpërndarjes së aseteve, pajisjeve dhe materialeve të inventarit, dhe përmbushjes së detyrimeve të tjera të aplikueshme të Projektit, me kërkesë të Partnerit, SC do t'i japë Partnerit një konfirmim me shkrim të kryerjes së kënaqshme të Projektit. Ky konfirmim nuk do të cenojë asnjë të drejtë që i lind SC sipas kësaj Marrëveshjeje dhe anekseve të saj, dhe kjo vlen edhe për periudhën pas përfundimit të Marrëveshjes.

## 26 SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme, të cilat do t'i bashkëngjiten versionit përfundimtar të nënshkruar, janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Shtojca A Dokumentet e Projektit (që përfshijnë Përshkrimin e Projektit/Fushën e Veprimit, Planin e Detajuar të Zbatimit, Kuadrot Logjike, Planet Vjetore të Veprimtarive, dokumentacionin e Dhuratave në Natyrë përfshirë vlerësimin e tyre etj.)

Shtojca B Buxheti i Projektit

Shtojca C Formatet e Raportimit

- Shtojca D Kushtet e Donatorit
- Shtojca E Politikat e SC për Ruajtjen e Sigurisë së Fëmijëve
- Shtojca F1 Politikat e SC Kundër Ngacmimit, Frikësimit dhe Bullizmit
- Shtojca F2 Politikat e SC MShAS (Mbrojtjen nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual)
- Shtojca G Politikat e SC për Mashtrimin, Ryshfetin dhe Korrupsionin
- Shtojca H Politikat e SC për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Skllavërinë Moderne
- Shtojca I Procedura e Prokurimit e SC  
[ELIMINOJENI NËSE PARTNERI PËRDOR NJË PROCEDURË TIJËN ME  
MIRATIMIN E QENDRËS SË PROKURIMEVE TË SC – SHIHNI UDHËZIMET]
- Shtojca K Plani i Vlerësimit të Partneritetit dhe Forcimit të Kapaciteteve [FUTNI PLANIN  
E VLERËSIMIT TË PARTNERITETIT DHE FORCIMIT TË KAPACITETEVE – SHIHNI  
UDHËZIMET]



Përmes nënshkrimit të mëposhtëm, SC dhe Partneri bien dakord lidhur me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje, përfshirë gjithë shtojcat e saj. Secila nga palët do të nënshkruajë dy kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje dhe do t'ia japë një të tjetër për regjistrat e saj.

Nënshkruar në emër të:

**Save the Children**

Emri: Anila MEÇO

Titulli: Drejtore e Save the Children

Data: {7 tetor 2022}



Nënshkruar në emër të:

**Bashkia Lezhë**

Emri: Pjerin NDREU

Titulli: Kryetar i Bashkisë Lezhë

Data: {7 tetor 2022}

